REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1094120
Date/Datum. 21.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Shefkinaze Vllasaliu	**17.12.2020**	**21.12.2020**	**1094-20**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.12.2019, Tenderuesi : Grup i Operatorëve Ekonomik **"KAG asphalt company" & "Vllezërit e Bashkuar"** SHPK **& " K-ING"** SHPK, Krushë e Vogël - Prizren, ka parashtruar ankesë me nr.: 1094-20, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (04.12.2020) - njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë, tenderuesi "RENELUAL TAHIRI" SH.P.K., Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në fshatin Zhur të Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-6607-5-2-1, dhe numër të brendshëm : 622-20-180-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: **punë**, vlera e parashikuar e kontratës: 490,000.00 €,

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Tenderuesi ankues, Grup i Operatorëve Ekonomik **"KAG asphalt company" & "Vllezërit e Bashkuar"** SHPK **& "K-ING"** SHPK, Krushë e Vogël - Prizren, pretendon se AK, ka bërë shkelje te dispozitave të *Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (më tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së dhe atë konkretisht:*

Neni 7, *Barazia në trajtim/Jo diskriminimi*

Neni 59, *Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

Neni 69, *Aftësia Teknike dhe/ ose Profesionale,*

8. Deklarartë detale mbi faktet dhe argumentet

Neni 7 i LPP përcakton diskriminimin ne trajtim andaj një këtë rast konsiderojmë se është shkelur kjo dispozitë me faktin që me kontratë Autoriteti Kontraktues e ka shpërblyer Operatorin Ekonomik i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes së tenderit posaçërisht certifikatat e cilësisë.

Neni 59 i LPP përcakton ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, konsiderojmë se me rastin e ekzaminimit dhe posaçërisht vlerësimit të tenderëve është shkelur kjo dispozitë kur komisioni vlerësues nuk ka zbatuar dhe respektuar te gjitha rregullat me rastin e vlerësimit te dosjeve të tenderit.

Neni 69 i LPP përcakton kapacitetin teknik dhe profesional, ku në këtë rast konkretisht kemi të bëjmë me shkeljen te par.2 pika 2.5 të kësaj dispozite për shkak se Operatori Eknomik i cili është shpërblyer më kontratë nuk i ka plotësuar kriterin profesional konkretisht nuk i ka poseduar Certifikatën ISO 45001.2018 te kërkuar sipas dosjes sit tenderit

Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit lidhur më kapacitetin teknik dhe profesional në pikën 9.1 dhe 9.2 përpos tjerash ka kërkuar dhe Certifikatën ISO 45001:2018 lidhur më Sistemin e Menagjimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, ISO 9001:2015 lidhur më Sistemin e Menagjimit të Cilesisë dhe ISO 14001:2015 lidhur më Sistemin e Menagjimit të Mjedisit. Në rastin konkret parashtruesi i kësaj ankese respektivisht grupi i operatorëve ekonomik në emër të cilëve është parashtruar kjo ankesë përpos tjerash i ka plotësuar edhe kërkesat nga këto standarde të cilësisë duke dorëzuar certifikatat përkatëse, ndërsa në anën tjetër Operatori Ekonomik i cili është shpërblyer më kontratë konkretisht NNP "RENELUAL TAHIRI", SH.P.K nuk i ka plotësuar kërkesat nga këto standarde, pra ka dorëzuar certifikaten ISO 9001:2015 lidhur me Sistemin e Menagjimin të Cilësisë dhe certifikaten ISO 14001:2015 lidhur më Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit, ndërsa nuk e ka dorëzuar fare Certifikatën e kërkuar ISO 45001:2018 lidhur më Sistemin e Menagjimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë e cila shprehimisht është kërkuar në dosjen e tenderit. Andaj duke i pasur për këto të dhëna të cilat u theksuan më lartë, e të cilat fakte provohen me prova materiale, pra më certifikatat e dorëzuara, aktvendimin e Autoritetit Kontraktues të dt.04.12.2020 e bënë të pa qëndrueshëm dhe të pa bazuar në ligj, posaqërisht arsyetimin e tij, të cilit i bashkangjitet e fotokopjuar një pjesë e një akti tjetër në fotokopje, e cila në këtë mënyrë dhe formë, dhe pa u lëshuar në autenticitetin dhe përmbajtjen e tij e bënë të pa qëndrueshëm dhe jashtë çdo standardi dhe kërkesave ligjore që duhet të përmbajë një aktvendim, pra thjeshtë dhe qartë një aktvendimi sikurse në rstin konkret në asnjë mënyrë dhe rrethanë nuk mund ti bashkangjitet në formën e fotokopjes një pjesë e një akti tjetër, por arsyetimi duhet të jetë tërësi unike dhe integrale.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ju qe te merrni:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE "KAG - Asphalt Company SH.P.K.; "Vllezerit e Bashkuar"Sh.p.k. si e bazuar, dhe lënda te kthehet ne RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimit dhe krahasimi i ofertave te bëhet ne harmoni me kërkesat e dosjes sit tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave te LPP-se.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, nuk janë të njëjta me ato të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim, ka dallime në mes tyre.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 4 OE duhet të kjetë i qertefikuar dhe i pajisur me këto standarde
a. Certifikim ISO 45001 2018 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune.
b. ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë
c. ISO 14001 -Sistemet e menaxhimit të mjedisit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmija 4. Certifikim ISO 45001 2018 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune.
b. ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë
c. ISO 14001 -Sistemet e menaxhimit të mjedisit.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:
Komisioni nuk ka dhënë vërejtje përmbyllëse.

DEKLARATË

Me kontrate propozohet te shperblehet Oe; Renelual Tahiri me cmimin e ofruar prej; 388.857,00 €uro.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Tenderuesi ankues, Grup i Operatorëve Ekonomik **"KAG asphalt company" & "Vllezërit e Bashkuar"** SHPK **& "K-ING"** SHPK, Krushë e Vogël - Prizren, *është palë me interes sipas nenit 4.1.26* nga rezultati i këtij aktivitetit të prokurimit të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, në raport me këtë kontratë që mund të jetë në rrezik të dëmtimit material nga një shkelje e pretenduar.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasë.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Tenderuesi Ankues, Grup i Operatorëve Ekonomik **"KAG asphalt company" & "Vllezërit e Bashkuar"** SHPK **& "K-ING"** SHPK, Krushë e Vogël - Prizren, deklaron se Nuk pajtohet me Njoftimin mbi vendimin e publikuar nga AK- KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT të datë 25.11.2019. dhe PRETENDON se AK ka bërë gabim gjate vlerësimit të tenderit.

Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas tenderuesit ankues, nga ana e Autoriteti Kontraktues, janë:

Neni 7, *Barazia në trajtim/Jo diskriminimi*

Neni 59, *Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

Neni 69, *Aftësia Teknike dhe/ ose Profesionale,*

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar **sqaron me sa vijon:**

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 7)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (**Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**) është i pabazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm me çmim më të ulët. Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së tenderuesit "RENELUAL TAHIRI" SH.P.K., Prizren, fitues për këtë kontratë nuk ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, nuk ka bërë kurrfarë favorizimi të ofertës së tij, i cili sipas vlerësimit nga ana ime është i përgjegjshëm, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me diskriminimin e tenderuesit ankues.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 59),Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i pabazuar, sepse me kontrollimin dhe rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

Tenderuesi i shpallur fitues "RENELUAL TAHIRI" SH.P.K., Prizren, i ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1 & 9.2. Kërkesa 4 nga Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), faqe 14-15 të DT:

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 4 OE duhet të kjetë i qertefikuar dhe i pajisur me këto standarde
a. Certifikim ISO 45001 2018 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune.
b. ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë
c. ISO 14001 -Sistemet e menaxhimit të mjedisit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmija 4. Certifikim ISO 45001 2018 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune.
b. ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë
c. ISO 14001 -Sistemet e menaxhimit të mjedisit.

- Eksperti shqyrtues në bazë të dokumentacionit të dorëzuar me ofertë-tender, ka konstatuar se pretendimi i palës ankuese në ankesë, se Tenderuesi i shpallur fitues në tenderin e tij, ka dorëzuar Certifikaten ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë dhe Certifikaten ISO 14001 -Sistemet e menaxhimit të mjedisit, por nuk e ka dorëzuar Certifikaten ISO 45001 2018 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune,

është i pa bazuar.

Tenderuesi i shpallur fitues "RENELUAL TAHIRI" SH.P.K., Prizren, në tenderin e dorëzuar e ka dorëzuar Cetifikaten BS OHSAS 18001 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune, e cila certifikatë është e njejt me Certifikaten ISO 45001 2018.

Certifikata BS OHSAS 18001 është valide, ku për të njëjtën nga kompania përgjegjëse e akredituar për certifikim, është dhënë një periudhe tranicioni qe do te perfundoje deri me datë 11.03.2021.

Këtë sqarim dhe informatë Autoriteti Kontraktues (KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT) e ka marrë nga Kompania e akredituar për certifikim, AQSCERT në Shqipëri (http://aqscert.org/) të cilat informata i kamë vertetuar në këtë faqe zyrtare, andaj tenderuesi i shpallur fitues ka dorëzuar tender të përgjegjshëm *e që është në në pajtueshmëri me kërkesat e saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.*

Informata të tilla se BS OHSAS 18001 është certifikatë e njëjtë me Certifikaten ISO 45001 2018, mund të gjinden për veç në faqen http://aqscert.org/ edhe në faqet zyrtare tjera
https://www.iso.org/standard/63787.html
https://www.bsigroup.com/en-GB/ohsas-18001-occupational-health-and-safety/

Informatat për BS OHSAS 18001, Sistemi i Menaxhimit te Sigurisë dhe Shëndetit ne Pune, është një Standard Britanik për sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Pajtueshmëria me të u mundësoi organizatave të demonstronin se kishin një sistem të vendosur për shëndetin dhe sigurinë në punë. BSI anuloi BS OHSAS 18001 për të adoptuar ISO 45001 si BS ISO 45001. ISO 45001 u botua në Mars 2018 nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim. Organizatat që janë çertifikuar në BS OHSAS 18001 mund të migrojnë në ISO 45001 deri në Mars 2021 nëse duan të mbajnë një çertifikim të njohur.

Prandaj pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk ka shkelje të nenit 59 të LPP-së, sepse vlerësimi është bërë në pajtueshmëri ne këtë nen. Fitues është shpallur tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që të REFUZOHET ankesa e Tenderuesit ankues, Grup i Operatorëve Ekonomik **"KAG asphalt company" & "Vllezërit e Bashkuar"** SHPK & **"K-ING"** SHPK, Krushë e Vogël - Prizren, **e pabazuar,**
njëherësh propozoj, **që të aprovohet** Vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në fshatin Zhur të Prizrenit", i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT dhe të vazhdojë sipas dispozitave të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues : - Grup i OE **"KAG asphalt company" & "Vllezërit e Bashkuar"** SHPK & **"K-ING"** SHPK, Krushë e Vogël – Prizren.